



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

*E nderuar Kryesuese e Seancës,*

*Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,*

Ju falenderoj për ftesën për të prezantuar përpara jush Raportin Vjetor për vitin 2022 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Viti 2022 ka pasur një sërë zhvillimesh të rëndësishme në tregjet financiare jobankare, si edhe në procesin e negociatave me Bashkimin Evropian. Pavarësisht ndikimeve në segmente të caktuara të tregjeve nën mbikëqyrje gjatë vitit të kaluar, për shkak të presioneve inflacioniste, aktualisht këto tregje shfaqen të qëndrueshëm dhe i janë rikthyer trendit rritës.

Tregu i sigurimeve vijoi konsolidimin e treguesve, rritje të primeve të shkruara bruto dhe rritje të dëmeve të paguara në numër e në vlerë. Raporti i numrit të dëmeve pezull kundrejt totalit të dëmeve të raportuara në tregun e Jo-Jetës zbriti në nivelin më të ulët historik.

Ligji i ri për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit ka dhënë impakt të konsiderueshëm në treg, duke sjellë uljen e shpenzimeve të marrjes në sigurim, reduktimin e praktikave të mbartura të Fondit të Kompensimit, si edhe përdorimin e Raportit Evropian të Aksidenteve. Ndërhyrjet ligjore sollën gjithashtu përmirësim të ndjeshëm të situatës me Byronë Shqiptare të Sigurimit, e cila doli nga monitorimi thuajse 10-vjeçar i Këshillit të Byrove.

Në tregjet e kapitalit, subjektet përfunduan procesin e përshtatshmërisë me kërkesat e ligjit të ri, si edhe zgjeruan licencat, duke diversifikuar shërbimet e investimit dhe instrumentet financiare të ofruara për investitorët. U plotësua më tej baza ligjore e nënligjore dhe infrastruktura e tregjeve të kapitalit. Bordi i Autoritetit miratoi prospektin e parë të një shoqërie tregtare për emetim obligacionesh me ofertë publike.

Viti i kaluar solli avancime të rëndësishme ligjore e rregullatore edhe në drejtim të përafrimit të mëtejshëm me direktivat dhe acquis të BE. Autoriteti, në kuadër të negociatave, drejton Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”. Në takimet bilaterale të zhvilluara në Bruksel, Komisioni Evropian theksoi se Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm sa i përket plotësimit të rekomandimeve dhe përafrimit ligjor e rregullator në fushën e shërbimeve financiare.

Gjatë vitit 2022, Autoriteti plotësoi më tej bazën rregullatore, në zbatim të ligjeve të reja në tregjet nën mbikëqyrje, të përafruara me direktivat evropiane, si edhe përfundoi hartimin e projektligjit “Për fondet e pensionit privat”, i përafruar në masë të gjerë me Direktivën përkatëse të BE-së, IORP II.

Në një tjetër zhvillim për t’u veçuar, Autoriteti shënoi përparim domethënës në vlerësimin e bërë nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS). Në raportin përfundimtar, rezultoi një nivel i lartë përputhshmërie, ku nga 24 Parime Themelore Bazë, 10 u vlerësuan plotësisht të përputhura me parimet ndërkombëtare dhe 12 të tjera të përputhura gjerësisht.

IAIS vlerëson se “AMF ka ndërmarrë reforma të gjithanshme gjatë viteve të fundit, duke forcuar ligjin kuadër, si edhe rishikuar ligjet dhe rregulloret në tregun e sigurimeve. Progresi është udhëhequr nga objektivi i përafrimit me kërkesat e BE-së. Aktiviteti rregullator, thekson IAIS, karakterizohet nga objektiva të qarta dhe pavarësi institucionale, ekziston një kuadër ligjor i zhvilluar për licencimin, veprimet e tjera rregullatore, kërkesat për përshtatshmëri, mirëqeverisjen dhe menaxhimin e riskut, përfshirë risqet e lidhura me risigurimin.”

Autoriteti miratoi në fillim të këtij viti strategjinë 5-vjeçare 2023-2027, e cila përcakton disa drejtime të rëndësishme për zhvillimin afatmesëm, si forcimi i stabilitetit financiar, rritja e efektivitetit të mbikëqyrjes dhe integritetit të tregjeve, përafrimi i legjislacionit me standardet evropiane, zhvillimi dhe modernizimi i tregjeve, mbrojtja e interesave të konsumatorit dhe investitorit, financimi i gjelbër, si edhe digjitalizimi dhe përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Një nga objektivat e strategjisë është implementimi i udhërrëfyesit për zbatimin e regjimit mbikëqyrës evropian në sigurime, Solvency II, i hartuar me asistencën e Bankës Botërore.

Autoriteti është angazhuar që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të zbatojë Planin e Veprimit të Dokumentit Politik “Për Krijimin e një Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Tregjeve të Kapitalit në Shqipëri, 2023-2027”, i miratuar nga Këshilli i Ministrave në muajin prill të këtij viti. Dokumenti vendos disa prioritete strategjike, si rritja e pjesëmarrjes së emetuesve, zgjerimi i bazës së investitorit dhe zgjerimi i gamës së instrumenteve financiare.

Referuar më konkretisht ecurisë së tregjeve nën mbikëqyrje, **në tregun e sigurimeve,**

**Dëmet e paguara në numër në vitin 2022 ishin në nivelin më të lartë historik.**

Numri i kërkesave për dëmshpërblim të paguara nga shoqëritë e sigurimit gjatë vitit të kaluar arriti një vlerë totale prej 6.25 miliardë lekë. Pagesat e larta të dëmeve gjatë vitit 2022, sollën edhe ulje të stokut të dëmeve në status pezull. Në fund të vitit të kaluar, dëmet pezull të shoqërive të sigurimit ishin vetëm 13.4% e gjithë dëmeve të trajtuara nga ana e tyre.

**Niveli i komisioneve të ndërmjetësimit në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik u reduktua ndjeshëm.** Hyrja në fuqi në janar 2022 e rregullores së miratuar nga Autoriteti solli ulje domethënëse të komisioneve të ndërmjetësimit në nivel tregu për sigurimet e detyrueshme motorike, nga mesatarisht 27%, këto komisione kanë zbritur tashmë në 16%.

**Byroja Shqiptare e Sigurimit (BSHS) doli nga monitorimi 10-vjeçar i Këshillit të Byrove.** Në vitin 2013, BSHS ishte vendosur në status monitorimi, për shkak të problematikave të mbartura. Përmirësimi i ndjeshëm i situatës, falë ndryshimeve të fundit ligjore dhe monitorimit të shtuar nga ana e Autoritetit, solli në dhjetor të vitit 2022 daljen e Byrosë Shqiptare të Sigurimit nga monitorimi i Këshillit të Byrove.

**Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për sigurimet e detyrueshme në sektorin e transportit, ka patur përmirësim të ndjeshëm të situatës me Fondin e Kompensimit.** Rreth 87% e praktikave të dëmeve për aksidente të ndodhura pas hyrjes në fuqi të ligjit, 1 korrik 2022, janë paguar me procedura më të përshpejtuara përmes siguruesit të drejtpërdrejtë. Si një tjetër risi e ligjit, edhe **Raporti Evropian**

**i Aksidenteve**, zgjidhja me marrëveshje mes drejtuesve, rezulton të jetë përdorur në rreth 23% të rasteve për dëmet TPL të trajtuara gjatë vitit 2022.

Përgjithësisht, u shënuar një përmirësim i mëtëjshëm i treguesve financiarë kryesorë që monitorohen nga Autoriteti. Kapitali dhe aftësia paguese e shoqërive të sigurimit shënuan rritje të mëtëjshme, ashtu si edhe treguesi i aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike. Tregu i sigurimeve e mbylli vitin 2022 me një rritje prej 9.2% të primeve të shkruara bruto, duke arritur në rreth 21 miliardë lekë të ardhura.

**Në tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive**, gjatë vitit 2022, zhvillimet në tregjet ndërkombëtare, shoqëruar me rritjen e normave të interesit sollën ndikime në sjelljen e investitorëve, përmes një riorientimi të investimeve të tyre brenda sistemit financiar. Rritja e normave bazë të interesit ndikoi në vlerën e portofoleve të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, të cilat pësuan rënie të vlerës së aseteve neto. Në anën tjetër, nga monitorimi i të dhënave të tregut me pakicë të titujve të Qeverisë u shënuar një rritje me 216% e blerjeve të individëve në tregun primar, çka tregon lëvizjen e fondeve të investitorëve të tregut të sipërmarrjeve të investimeve kolektive brenda sistemit financiar.

Referuar fondeve të investimit, Autoriteti ka ndërhyrë me një sërë masash gjatë vitit 2022, si edhe po vijon monitorimin e kujdesshëm të situatës. Nga mbikëqyrja e deritanishme e këtij tregu, mbi bazën e raportimeve me frekuencë të shtuar, si dhe nga raportimi financiar i shoqërive administruese, ka rezultuar se treguesit e likuiditetit për të gjitha fondet e investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike kanë qenë në përputhje me kërkesat rregullatore për likuiditetin. Në muajt e parë të vitit 2023, fondet e investimeve i janë rikthyer rritjes dhe konstatohet një trend rikuperues, megjithatë Autoriteti do të monitorojë në vijimësi ecurinë e këtij tregu.

Sa i përket zhvillimeve të tjera, në tregun e kapitaleve, në vitin 2022, në drejtim të zgjerimit të llojeve të shërbimeve të investimit, për herë të parë u licencuan dy subjekte (banka) për ofrimin e shërbimit të nënshkrimit të titujve (underwriting), u licencua një bankë për ofrimin e shërbimit të administrimit të portofoleve individuale, si dhe për shërbimin e këshillimit në investime, si edhe u autorizua një bankë për të ofruar shërbimin e shitjes online të bonove të thesarit, përmes një

platforme digjitale.

Tregu i obligacioneve të emetuara me ofertë private shënoi rritje të mëtejshme gjatë vitit 2022. Shuma e pashlyer e këtij instrumenti financiar arriti në rreth 14 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 40%, krahasuar me fundvitin 2021.

**Tregu i фондеве të pensionit privat** ka vijuar tendencën e tij në rritje, si në vlerën e aktiveve neto, ashtu edhe në numrin e anëtarëve. Pritshmëritë janë që ligji i ri t'i japë një shtysë të mëtejshme zhvillimit të këtij tregu.

Autoriteti ka forcuar bashkëpunimin me organizatat dhe institucionet financiare ndërkombëtare, si edhe autoritetet homologe rajonale dhe evropiane. AMF aderoi në Memorandumin Shumëpalësh të Mirëkuptimit, të Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), duke u bërë rregullatori i parë në rajonin e Ballkanit Perëndimor që bëhet pjesë e këtij Memorandumi. Kjo pjesëmarrje i shërben shkëmbimit të informacionit dhe mbikëqyrjes efektive të grupeve ndërkufitare të sigurimeve. Gjithashtu Autoriteti ka nënshkruar marrëveshje me homologët e Austrisë, Maltës e Luksemburgut.

*Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,*

Në mbështetje të Strategjisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare 2023-2027, gjatë vitit 2023, Autoriteti do të vijojë të kontribuojë në nxitjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e sigurt të tregjeve financiare nën mbikëqyrje, duke luajtur rol proaktiv në funksion të mirërregullimit dhe zhvillimit të këtyre tregjeve. Gjithashtu, mbetemi të angazhuar për të përmbushur rekomandimet e ekspertëve të Komisionit Evropian dhe për të vijuar me procesin e përafrimit të akteve ligjore e nënligjore me acquis të BE-së.

Duke patur si objektiv themelor mbrojtjen e konsumatorit dhe investitorit, Autoriteti do të vijojë punën në drejtim të rritjes së kërkesave për transparencë dhe informacion nga subjektet e tregjeve nën mbikëqyrje, sipas standardeve ndërkombëtare. Gjithashtu, Autoriteti do t'i kushtojë vëmendje zhvillimit të financimit të gjelbër e të qëndrueshëm, si edhe harmonizimit me praktikat më të mira evropiane në këtë fushë. Në fokus, do të jenë proceset e digjitalizimit dhe përmirësimi i sistemeve të

teknologjisë së informacionit, edhe në funksion të rritjes së efikasitetit të mbikëqyrjes.

Në fund, më lejoni të theksoj se Autoriteti do të ndjekë me përparësi dhe do të angazhohet për plotësimin e rekomandimeve të Kuvendit, të shprehura përmes rezolutës që miratohet në këtë seancë plenare.

Shumë Faleminderit!